



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

| | |
|--------------------------------|--|
| Drejtoria | Drejtoria e Parqeve |
| Periudha raportuese | Janar, 2020 |
| Emri dhe mbiemri i raportuesit | Fatime Hajdari, drejtoresh e Drejtorisë së Parqeve |

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Parqeve ka vazhduar përgjatë muajit janar realizimin e detyrave të caktuara në bazë të planit të punës, për trajtimin e hapësirave të gjelbra në komunën e Prishtinës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- *Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana e NPK "Hortikultura", krasitja e drurëve, prerja e drurëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;*
- *Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbra në secilën zonë të kryeqytetit;*
 - *Mbrojtja dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbra brenda territorit të komunës së Prishtinës;*
 - *Mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë;*
- *Nxitja, promovimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve rekreative për fuqizimin e jetesës aktive nëpërmjet edukimit e sensibilizimit për një jetesë të shëndetshme, në bashkëpunim me sektorë të tjerë përgjegjës;*
 - *Organizimi dhe koordinimi i planeve operacionale të gjelbërimit për sezonin pranveror 2020;*
 - *Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete kulturore (jo afariste);*
- *Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative "Gërmia" për aktivitete kulturore dhe rekreative;*

- *Pranimi i informatave nga qytetarët, respektivisht nga subjektet tjera komunale dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen;*
- *Identifikimi i këndeve të dëmtuara të lodrave.*

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:*

- *Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPK "Hortikultura", krasitja e drurëve, prerja e drurëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;*
- *Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbra në secilën zonë të kryeqytetit;*
- *Mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë sipas kontratës;*
- *Koordinimi i planeve operationale të gjelbërimit për vitin 2020;*
- *Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete kulturore (jo afariste);*
- *Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës rekreative "Gërmia" për aktivitete kulturore dhe rekreative;*
- *Identifikimi i këndeve të dëmtuara të lodrave;*
- *Mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë;*

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.*

- *Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPK "Hortikultura";*
- *Mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë;*
- *Dërgimi i projekteve të parqeve për procedura të prokurimit;*
- *Nxitja, promovimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve rekreative për fuqizimin e jetesës aktive nëpërmjet edukimit e sensibilizimit për një jetesë të shëndetshme, në bashkëpunim me sektorë të tjerë përgjegjës;*
- *Identifikimi i hapësirave publike për rigjenerim të tyre përmes projekteve;*
- *Përmirësimi i infrastrukturës në parqet ekzistuese;*
- *Përgatitjet për shënimin e kampanjës me rastin e 50-vjetorit të Ditës së Tokës;*
- *Finalizimi i dokumentit të Planit të menaxhimit për peizazhin e mbrojtur "Gërmia";*

- *Mbjellja e pemëve në hapësirat e qytetit në kuadër të pyllëzimit urban, të pranuar nga donacionet e organizatave të ndryshme.*

4.1.2 Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

Për periudhën raportuese janë proceduar për pagesë: -

4.1.3 Takimet me palë

Takimet me palë janë pjesë e procesit të punëve të përditshme, të cilat realizohen në bazë të shqyrtimit të kërkesave që kanë të bëjnë me çështje të hapësirave të gjelbra dhe rigjenerimit të tyre.

5. Takimet me institucione të tjera

6. Diskutime publike / takime me qytetarë

Gjatë periudhës raportuese nuk është zhvilluar ndonjë diskutim publik, mirëpo janë takuar në vazhdimësi qytetarë për çështje të ndërlidhura me hapësirat e gjelbra të qytetit.

6.2. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

6.3. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

Numri i lëndëve të pranuar - 6,

Numri i lëndëve të kryera - 6,

Numri i lëndëve në proces - 0.

7. Takime të tjera

Takim me ekipin monitorues italian Liason Monitoring Team (LMT);

Takim me përfaqësues të organizatës WWF Adria;

Takim me përfaqësuesin e organizatës "Humanity First", mbi mundësinë e një

donacioni për hapësirat e gjelbra të komunës së Prishtinës;

Takim me përfaqësuesen e "Rotary Club Prishtina" në lidhje me një donacion të rregullimit të një hapësire publike të gjelbër në komunën e Prishtinës.

SFIDAT - Nëse gjatë zbatimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Gjatë realizimit të projekteve për këtë periudhë nuk kemi pasur pengesa për realizimin e tyre.

8. REKOMANDIME - *Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.*

Mundësia e plotësimit të stafit të punëtorëve të dikasterit të Parqeve përmes procedurave të rekrutimit.

9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - *Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:*

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPK "Hortikultura";*
- Organizimi dhe koordinimi i planeve operacionale të gjelbërimit;*
- Finalizimi i projekteve ideore për hapësira të reja rekreative sipas planit të veprimit;*
- Mirëmbajtja e këndeve të lodrave;*
- Dhënia e pëlqimeve për shfrytëzimin e Qendrës rekreative "Gërmia" për aktivitete kulturore dhe rekreative;*
- Nxitja, promovimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve rekreative për fuqizimin e jetesës aktive nëpërmjet edukimit e sensibilizimit për një jetesë të shëndetshme, në bashkëpunim me sektorë të tjerë përgjegjës;*
- Koordinimi i kampanjës për dhurimin e donacioneve të fidanëve për sezonin e pranverës;*
- Përgatitjet për shënimin e kampanjës me rastin e 50-vjetorit të Ditës së Tokës.*

10. TË TJERA - *Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.*

